KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 41/2026
Hagë, 12/11/2026

Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, më 6 nëntor dhe 10 nëntor 2026, Trupi Gjykues miratoi dy kërkesa të Mbrojtjes së Viktimave për të lejuar një të afërm të dy viktimave që kanë ndërruar jetë që të vazhdojë të marrë pjesë në proces në emër të tyre. Më 10 nëntor 2026, Trupi Gjykues miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave për zgjatje të afatit dhe të numrit të lejuar të fjalëve për t'iu kundërpërgjigjur përgjigjes së përbashkët të Mbrojtjes lidhur me zhdëmtimet. Në këtë çështje marrin pjesë 156 viktima.

Në të njëjtën çështje, më 6 dhe 11 nëntor 2026, Trupi Gjykues urdhëroi të bëheshin publike versionet me më pak redaktime të transkripteve të dëshmive të 8 dëshmitarëve. Ky urdhër ishte në vijim të vendimeve të mëparshme të Trupit Gjykues për t'i bërë publike dëshmitë fillimisht konfidenciale të 49 dëshmitarëve.

Këto vendime pasqyrojnë karakterin publik të procesit dhe përkushtimin e gjykatësve për transparencë. Gjatë gjykimit për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, shumica e dëshmitarëve dhanë dëshmi tërësisht ose kryesisht në seanca publike dhe 61 dëshmitarë dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse. Dëshmitë e dëshmitarëve që fillimisht ishin konfidenciale rishikohen vazhdimisht, në mënyrë që sa më shumë dëshmi të bëhen publike më pas, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen në vijimësi të viktimave dhe dëshmitarëve. Transkriptet dhe videot e seancave publike mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së, ku janë të organizuara sipas datës së seancës, ose në kanalin e Gjykatës në *YouTube*.

Në çështjen gjyqësore *Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit*, shqiptimi i Aktgjykimit është caktuar të mbahet të martën që vjen, 17 nëntor 2026, duke filluar në orën 10:00 paradite. Seanca do të transmetohet përmes faqes transmetuese në internet, ku mund të shihet ngado në botë, në shqipe, anglishte ose serbishte, me një vonesë të shkurtër prej 10 minutash. Incizimi i seancës do të vendoset edhe në kanalin *YouTube*.

Sipas Aktakuzës, të paktën mes 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të ndryshme jo të privilegjuara në objektin e paraburgimit, Hashim Thaçi u dha Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Fadil Fazliut informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të Prokurorisë dhe, së bashku me ta, si dhe me persona të tjerë për të cilët nuk janë ngritur akuza, u përpoq të ndikonte në dëshmitë e disa dëshmitarëve. Në Aktakuzë pretendohet gjithashtu se z. Thaçi ra në marrëveshje me z. Kuçi që ky i fundit të kontaktonte dëshmitarë të Prokurorisë në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët,* në kundërshtim me urdhrin që ua ndalonte këtë përveç nëse ishin në përputhje me procedura të caktuara.

Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore u vetëdeklaruan të pafajshëm lidhur me të gjitha akuzat. Isni Kilaj u lirua me kusht në dhjetor të vitit të shkuar, ndërsa Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu u liruan me kusht

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine

në shkurt 2026. Z. Kuçi është mbrojtur në liri, dhe nuk ka qenë në paraburgim gjatë procedurës paraprake dhe gjykimit.

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine